

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	 PRISHTINA
	Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	

RAPORT VJETOR I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2019

1. Gjendja e sigurisë

Gjendja e përgjithshme e sigurisë gjatë vitit 2019 ka qenë e mirë dhe stabile. Sipas raportimeve të përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë dhe Policisë së Kosovës, nuk është regjistruar asnje ekses ndëretnik në territorin e Komunës së Prishtinës.

2. Qasja e komuniteteve joshumicë në shërbimet publike

Komunitetet joshumicë kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Komiteti për Komunitete, drejtoritë komunale me shërbimet e tyre përkatëse u kanë kushtuar mjaft kujdes anëtarëve të komuniteteve joshumicë, atyre që kanë kërkuar të pajisen me dokumentacion personal, familjar dhe pronësor.

3. Takimet e Komitetit për Komunitete

Gjatë vitit 2019 Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 takime, në të cilat takime janë shqyrtuar këto çështje:

- Hartimi i Planit të punës së Komitetit për vitin 2019;
- Bashkëpunimi me drejtoritë dhe institucionet e tjera të Komunës: Kryetarin, Nënkyetarin, Drejtorin e Administratës, Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, zyrtarët e OSCE-së, MKK, Polici në e Kosovës, KFOR-in, zyrtarë të organizatave jo qeveritare dhe ndërkombëtare;
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të anëtarëve të komuniteteve mbi gjendjen e tyre ekonomike-sociale, të sigurisë, dhe objektivat e përbashkëta të kthimit dhe riintegrimit;

- Vlerësimi i vizitave të kryera në rajonet me anëtarë të komuniteteve, institucioneve komunale-shkollave në mjeshterët ndëretnike, familjeve, organizatave shoqërore dhe aktivitetave të tjera në bazë të Planit të punës të Komitetit për Komunitetet në vitin 2019;
- Ka shqyrtuar evidencën e Familjeve të cënueshme të komuniteteve për ndihmë duke i njoftuar drejtore kompetente dhe zyrtarët komunal;
- Komiteti gjatë seancave ka nxjerrë shumë konkluzione, të cilat ia ka drejtuar drejtore përkatëse për t'i implementuar ato;
- Ka shqyrtuar dhe vlerësuar projekte të ndryshme për zhvillimin e komuniteteve jo shumicë të përgatitura nga ZKKK;
- Ka përcjell dhe përkrahur projektet e ndryshme për ndarjen e mjeteve përfituesve si dhe Shqyrtimin e e kërkesave të anëtarëve të komuniteteve joshumicë;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndihmë të të gjithë përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë për shënimin e festave nationale;
- Formimi (emërimi) i Komisionit për vizitë shkollave ku vijon mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë, si vijon: SHFMU "AsimVokshi"; SHFMU "EminDuraku" dhe në disa shkolla tjera. Vizita është realizuar me qëllim të Identifikimit të rasteve specifike sociale të nxënësve të komunitetit RAE; Dhe Identifikimin e rasteve që nuk vijon mësimor;
- Takim me drejtoren e Administratës, njoftim në lidhje me lëshimin e dokumenteve personale në gjuhët e komuniteteve serbe dhe turke;
- Shqyrtimi i raportit mbi vizitën në shkolla ku vijon mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë;
- Raport mbi ndjekjen e mësimit nga ana e nxënësve të komunitetit ashkali;
- Vizitë vendbane me të komuniteteve joshumicë në Bërnice të Poshtme, Bërnice të Epërme, Bardhosh, Lebanë, Besi dhe Slivovë;
- Raport mbi numrin e rasteve sociale të komuniteteve joshumicë;
- Raport mbi numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale të komuniteteve joshumicë (serbë, bosnjak, goran, ashkali, turk dhe rom).
- Vendosja e disa rrethojave në varrezat e Bardhoshit, Siçevës, Prapashticës dhe ndriçimit të disa rrugëve në Bardhosh;
- Transportimi i qytetarëve të Bërnicës së Poshtme;
- Raport mbi ofrimin e shërbimeve shëndetësore anëtarëve të komuniteteve joshumicë;
- Realizimi i programit të vaksinimit të fëmijëve të komunitetit ashkali dhe rom, dhe një varg diskutimesh të tjera në lidhje mirëqenien e këtyre komuniteteve.

4. Vizitat e Komitetit për Komunitete

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar në vitin 2019 vizitat në terren, si vijon:

- Vizitë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Vizite shkollave ku vijon mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë;
- Vizite vendbane me të komuniteteve joshumicë në Bërnice të Epërme, Bardhosh, Lebanë, Besi dhe Slivovë.

5. Kërkesat

Gjatë vitit 2019 Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ankesat e anëtarëve të komuniteteve: për dru zjarri, kontenjerë mbeturinash, ndihmë emergjente, strehim, riparime, kërkesa per rregullim rrugësh, trotuaresh, etj. Këto kërkesa janë proceduar në drejtoritë përkatëse për realizimin e tyre. Disa prej tyre janë realizuar, te tjerat presim pergjegje në vazhdim.

6. Projektet për zhvillim të komuniteteve joshumicë në Komunën e Prishtinës

Gjatë vitit 2019 Komiteti për Komunitete i përkrahi projektet për investime kapitale të dala nga Zyra për Komunitete, për zhvillim komuniteteve për vitin 2019.

Projektet për investime kapitale të dorëzuara në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe menaxhimit të kontratave për vitin 2019 janë, si vijon:

1. Propozim projekt për asfaltimin e rrugës në Prapashticë nga xhamia deri tek varret e poshtme në gjatësi prej 400 metra dhe prej xhamisë deri tek varrezat në gjatësi prej 300 metra (**Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave**);
2. Propozim projekt për rrëthimin e oborrit të xhamisë në Prapashticë me rrëthoj hekuri dhe themel betoni, përfshirë edhe oborrin e xhamisë së vjetër (**Drejtoria e Shërbimeve Publike**);
3. Propozim projekt për rrëthimin e varrezave në fshatin Siqevë (**Drejtoria e Shërbimeve Publike**);
4. Propozim projekt për asfaltimin e rrugës në Bërnicë të Poshtme në gjatësi prej 1 km afér kanalit të Ibër-Lepencit (**Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave**);

Projekte të realizuara gjatë vitit 2019 janë:

1. Ndertimi i trotuarit 2600 m dhe murit në Bernicë
2. Rregullimi i kanalizimit dhe asfaltimi i rrugës në Slivovë.

7. Konkluzionet

Gjatë vitit 2019 Komiteti për Komunitete nga takimet e mbajtura ka nxjerrë një sërë konkluzionesh, si vijon:

- Takimi me drejtorin e Investimeve Kapitale z. Gezim Mehmeti;
- Takimi me drejtorin e Arsimit znj. Shpresa Shala;
- Takimi me drejtorin e Administrates znj. Vasilika Zotaj Asllani;
- Takimi me drejtorin e Sherbimeve Publike z. Habib Qorri;
- Takimi me drejtorin e Financave znj. Valbona Makolli;
- Të formohet Komisioni i caktuar nga Komuna, që të dalë në terren dhe të identifikojë rastin në Bërnicë të Poshtme;
- Luten përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, që listën me emra të personave nga komuniteti i tyre që janë të shkolluar e që janë të papunë, ta dorëzojnë në ZKKK, në mënyrë që të kemi njoħuri ne si Komitet, se cili komunitet sa persona ka të shkolluar e janë të papunë;
- Kérkohet nga drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, të na njoftojë me shkrim rreth zbatimit apo mos zbatimit të kérkesave tona;
- Kérkohet nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, që të zgjidhet problemi i transportit të qytetarëve në relacionin Bërnicë - Kishnicë dhe anasjelltas;
- Kérkohet vendosja e shenjave, udhëtreguesi për Bërnicë;
- Kérkohet vendosja e shenjave të ndalimit të ndaljes së autobusëve në fillim të rrugës Bërnicë e Poshtme;
- Kérkohet nga Drejtoria e Pronës të shqyrton kérkesën e qytetarëve rreth pagesës apo mos pagesës së mbeturinave;
- Kérkohet vendosja e kontejnerit dhe semaforit te rrethi i Prishtinës, në dalje tēlagjes "Kalabria";
- Të vendosen zebrat në vendkalime;
- Të shikohet mundësia e mirëmbajtjes së tunelit që shpie në lagjen "Kalabria";
- Të eliminohen ujërat e zeza afér nénkalimit tek Xhamia e Llapit, të cilat po e rrezikojnë sigurinë e qytetarëve;
- Rastet që kanë të bëjnë me ndërtimin apo rinvimin e shtëpive për qytetarët e komuniteteve jo shumicë, të adresohen në ministrinë përkatëse;
- Kérkohet nga Drejtoria e Administratës, që mundësish të punësojëpunonjës në sportele të cilët e njohin gjuhën serbe;
- Kérkohet nga përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë, që të sjellin listën me emra të cilët kanë diplomë universiteti e që kérkojnë punë;
- Kérkohet nga ZKKK tē na sjellë listën me emra të atyre që kérkojnë me ukthyer tē jetojnë në Prishtinë.
- Tē njoftohet Drejtoria e Sherbimeve Publike pranë Kuvendit komunal tē Prishtinës, rreth që tē punoj në drejtim tē parandalimit të hedhjes së mbeturinave në mënyrë ilegale në tē gjitha vendet e Komunës së Prishtinës, e në veċanti në dalje tē Bërnicës së Poshtme, me kusht që tē na sjell tē dhëna rreth planit strategjik në parandalimin e hedhjes së mbeturinave;
- Drejtoria e Investimeve Kapitale tē del në teren ta identifikoj rastin e kanalizimit në Bërnicë tē Poshtme, dhe urgjentsiht tē ndermerr masa në evitimin e atij problemi;

- Për Drejtorin e Administratës, me kërkesën e përfaqësuesve të komunitetit boshnjak dhe turk ku e njëjta vlen edhe për komunitetin serb rrëth zgjedhjes së problemit në regjistrimin civil që ka të bëjë me respektimin dy gjuhësor.
- Për Drejtorin e Parqeve, të mirëmbahen varrezat e të gjitha komuniteteve.
- Komiteti për Komunitete përmes një shkrese, të njoftojë kryetarin dhe nënkyetarin lidhur me projektet e parealizuara për investime kapitale, si dhe mos prezencën e drejtoreve në takimet e Komitetit për Komunitete;
- Komiteti për Komunitete të reagojë me shkrim lidhur me rastet që kanë ndodhur kohën e fundit me komunitetin rom dhe ashkali, ku njëherësh edhe dënon rastet në fjalë.
- Kërkesa e perfaqeuesve jo shumice qe te shikohet mundësia e hapjes së Zyrave të Komuniteteve ne vendbanimet apo lagjet e tyre,
- Te respektohen te drejtat e komunitetit joshumicë në punësim dhe në përfaqësim;
- Pjesëmarrja e drejtoreve dhe zyrtarëve të tjera në seancat e Komitetit për Komunitete.

8. Sfidat

Gjatë vitit 2019 Komiteti për Komunitete i ka shqyrtuar dhe realizuar të gjitha aktivitetet që janë planifikuar sipas Planit të punës 2019 dhe Rregullores së punës të Komitetit për Komunitete.

Po ashtu, Komiteti për Komunitete ka pranuar raporte nga drejtoritë komunale për çështje të ndryshme të ndërlidhura me komunitetet joshumicë.

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave nga Komiteti për Komunitete është zgjidhur brenda afateve ligjore.

Sfidë kryesore mbetet implementimi i projekteve të investimeve kapitale, që të realizohet në kohë dhe mos të ketë vonesa në implementimin e tyre.

**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Hatem Kupina**

